

DATA: [27/06/2017]

**Kërkesë për Tender: Nr.Tenderit 1291504/06-17**

**Tender për ofertim të Veturave me qera**

**Data e mbylljes - Koha: [05/07/2017] – 16:00 h**

---

### **Përmbledhje e Advancing Together**

OJQ Advancing Together (AT) me seli në Prishtinë dhe me numër fiskal 601554539 është Shoqatë joprofitabile, ku si qëllim ka krijimin e mjedisit të qëndrueshëm në Kosovë për integrimin e komuniteteve përmes avokimit dhe përkrahjes zhvillimore, promovimin e të drejtave të njeriut; përkrahjen e trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve; përkrahjen e të gjitha komuniteteve në proceset integruese vendore, rajonale dhe Evropiane me qëllim të sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm për Republikën e Kosovës dhe Evropës Juglindore

AT financohet nga donacionet, si dhe është anëtarësuar në disa Organizata Ndërkombëtare, ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Institucionet e Republikës së Kosovës.. Për më tepër mund të shikoni në [www.advancing-together.org](http://www.advancing-together.org)

### **1. Kërkesa**

Advancing Together (AT), fton kompanite të kulifikuara RENT CAR që të marrin pjesë në tenderin për ofrimin e dy veturave me qera për periudhën **17/07/2017 – 31/12/2017**.

#### **Me rëndësi :**

Specifikacionet e sakta teknike janë të detajuara në të dhënat e mëposhtme

### **2. Informatat për Ofertë:**

#### **2.1. Dokumentet e Tenderit**

Të dhënat e mëposhtme do të jenë pjesë e këtij Tenderi

- Specifikacionet teknike
- Forma Teknike e Ofertës
- Forma Financiare e Ofertes
- Forma e regjistrimit të shitësit
- AT rregullat e përgjithëshme të kontratës

## 2.2 Këkesat për Qartësim

Ofertuesve u kërkohet që për ndonjë paqartësi të dërgojnë kërkesa në email [info@advancing-together.org](mailto:info@advancing-together.org) . **Afati i fundit për dërgimin e kërkesave për qartësim 23:59 datë 30/06/2017**

### **Me rëndësi:**

Ofertat nuk duhet të dërgohen në emailin e mësipërm.

AT do të përgjigjet në të gjitha pyetjet tuaja sa më shpejtë që është e mundur.

AT do të caktoj panelin vlerësues për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, si dhe pas vlerësimit të ofertave do të njoftojë palët ofertuese.

## 2.3 Oferta juaj

Oferta duhet të përgaditet në gjuhën shqipe

Ju lutem dërgoni ofertën tuaj duke përdorur **Dokumentet e Tenderit**, ofertat që nuk përputhen me formatet e kërkuara mund të mos merren në konsideratë.

Oferta juaj duhet të përbëhet nga dy zarfa

- Oferta teknike dhe
- Oferta financiare

### 2.3.1 Përmbajtja e ofertës teknike

#### **Me rëndësi:**

Asnjë informacion çmimi nuk duhet të përfshihet në ofertën teknike. Mosrespektimi i këtij kriteri mund të shkaktoj skualifikimin. Oferta teknike duhet të përmbajë të gjitha informatat e kërkuara.

#### **Detajet e ofertës teknike**

**Viti i prodhimit:** Në ofertë duhet të jetë i përfshirë viti i prodhimit të veturës që ofertohe, vetura nuk duhet të jetë me e vjetër se viti 2015

**Fuqia e motorit:** Në ofertë duhet të jetë e përfshirë fuqia e motorit, nuk duhet të ofertohe ndonjë veturë me fuqi me të vogël se 1.2

**Shpenzimet për KM:** Gjithashtu në ofertë duhet të përfshihen edhe shpenzimet mesatare për KM të veturës që ofertohe

**Sigurimi i veturës :** Në ofertë duhet të ceket që vetura që ofertohe ka sigurim të plotë KASKO, si dhe të detajzohet deri në çfarë shume mbulohet nga ky sigurim.

**KM të kaluara** : Në ofertë duhet të ceken KM-të aktuale të veturës që ofertohej si dhe çmimi i ofertuar nuk duhet të ketë limit të KM ve.

**Lloji i motorit** : Vetura duhet të jetë me naftë/benzinë andaj duhet të ceket në ofertë

**Me rëndësi :**

Ju mund të ofertoni disa lloje të veturave, dmth në ofertë mund të paraqiten dy apo më shumë lloje të veturave. **Nuk lejohet ofertimi i veturave 4x4**

**2.3.2 Përmbajtja e ofertës Financiare**

- Oferta financiare duhet të jetë në Euro;
- Duhet të specifikohet për secilën veturë të ofertuar çmimi për ditë dhe muaj;
- AT është e liruar nga TVSH andaj oferta duhet të jetë pa TVSH;
- Oferta duhet të jetë valide së paku 30 ditë nga data e përmbylljes së tenderit.

**2.4 Vlerësimi i Ofertës/ Forma e regjistrimit të shitësit:**

**2.4.1 Regjistrimi i Furnitorit**

**Të gjithë furnitorët e kualifikuar do të regjistrohen në data bazë pastaj do të shikohet, nëse i plotësojnë kushtet e prapaktuara**

Furnitorët duhet të dërgojnë:

- Certifikatën e biznesit,
- Vërtetimin që nuk kanë detyrime ndaj ATK-së,
- Kopja e numrit personal të pronarit.
- Dy referenca të kompanisë

**2.4.2 Vlerësimi Teknik:**

Vlerësimi i kriterit Teknik do të jetë i bazuar në kërkesat e parapara nga AT.

**2.4.3 Vlerësimi Financiar:**

Vlerësimi financiar do të bëhet vetëm për furnizuesit që e kalojnë Vlerësimin Teknik.

Të gjitha ofertat nga furnizuesit e para-kualifikuar do të vlerësohen në bazë të:

- Specifikacioneve të prapaktuara nga AT
- Çmimi për veturë krahasuar me specifikacionet e veturës
- Viti i prodhimit të veturës

## 2.5 Dorëzimi i Ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen me dorë në një zarf të jashtëm që tregon titullin e projektit, numrin e projektit dhe adresën si mëposhtë.

<b>[Emri i Projektit]:</b>	<b>Protection monitoring and durable solutions</b>
<b>[Numri i Projektit]:</b>	<b>1291504</b>
<b>[Emri i organizatës]:</b>	<b>Advancing Together</b>
<b>[Adresa]:</b>	<b>Rexhep Mala 27/A Prishtine</b>

**Zarfi i jashtëm duhet të përmbajë dy zarfa të brendshëm siç përshkruhet më poshtë**

Të dy zarfet e brendshëm tregojnë emrin dhe adresën e firmës suaj.

Zarfi i parë i brendshëm duhet të shënohet "Komponenti Teknik" dhe të përmbajë përbërësin e plotë teknik të ofertës suaj.

Zarfi i dytë i brendshëm duhet të shënohet "Komponenti Financiar" dhe të përfshijë ofertën financiare të firmosur dhe të vulosur.

**Me rëndësi :**

Oferta Teknike dhe oferta Financiare duhet të dërgohen në zarfa të ndarë, dështimi për ta bërë këtë mund të rezultoj në skualifikim.

**Data e fundit për dorëzim: [05/07/2017], 16:00.**

**Me rëndësi :**

Cdo ofertë e dorëzuar pas kësaj date ose e dorëzuar në një adresë tjetër mund të refuzohet nga AT -ja.

AT nuk do të jetë përgjegjës për gjetjen ose sigurimin e ndonjë informacioni që nuk është identifikuar në ofertë. Prandaj, për të siguruar se ka informata të mjaftueshme, ofertuesi duhet të ofrojë si pjesë të ofertës, çdo material përshkrues siç janë ekstraktet, përshkrimet dhe informatat e tjera të nevojshme që ajo do të rriste kuptimin e ofertës së tij.

**Me rëndësi:**

Oferta financiare do të hapet vetëm nëse pjesa teknike e furnizuesit të ofertës e ka kaluar testin dhe është pranuar nga AT si plotësuese e specifikimeve teknike.

## **2.6 Pranimi i Ofertës / Rregullat e përgjithshme të kontratës:**

AT-ja rezervon të drejtën të pranojë të gjithë ose një pjesë të ofertës suaj.

AT-ja mund të rrisë ose zvogëlojë përmbajtjen e propozuar gjatë dhënies së kontratës dhe nuk do të priste një ndryshim të rëndësishëm të shkallës së paraqitur. Çdo rritje apo ulje e tillë e kohëzgjatjes së kontratës do të negociohet me ofertuesin e suksesshëm si pjesë e finalizimit të shërbimit.

AT-ja, sipas gjykimit të saj, mund të zgjasë afatin e fundit për dorëzimin e ofertave, duke njoftuar me shkrim të gjithë furnizuesit e mundshëm. Zgjatja e afatit mund të shoqërojë një modifikim të dokumenteve të kërkesave të përgatitura nga AT-ja me nismën e vet ose në përgjigje të një sqarimi të kërkuar nga një furnizues i ardhshëm.

Kontrata do t'i jepet ofertës që konsiderohet më i përgjegjshëm ndaj nevojave, si dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të AT-së, duke përfshirë ekonominë dhe efikasitetin dhe vlerën më të mirë të ofertuar.

## **2.7 Kushtet e pagesës**

Çdo pagesë do të bëhet përmes sistemit e-banking, pagesa bëhet në fillim të cdo muaji, pra lëshohet fatura në fillim të muajit pastaj bëhet pagesa

Sami Canaj, Pozita: Menaxher i Financave dhe Administratës

Advancing Together